



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 55

Prishtinë, më 27 gusht 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Amir Ahmeti, Haki Demolli dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Mufera Şinik

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Visar Smajlaj, Nevahir Haziri – KDI, Arben Shamolli – ISKP, Nehat Dervishi – OSBE, Jeton Bytyçi – OSBE, Vlora Marmullahaj – EULEX dhe Artan Canhasi – EULEX.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 18.06 dhe 02.07.2012;
3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë juridike falas;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për procedurën përmbarimore;
5. Shqyrtimi i projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës;
6. Shqyrtimi i kërkesës së pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-124 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-203 për Metrologji;

8. Njoftimi i Komisionit me formularët e deklaramit të pasurisë për zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që si pika të rendit të ditës të radhiten:

- a. Reagimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Institutit Gjyqësor lidhur me projektligjin për pagat e funksionarëve publikë,
- b. Njoftim me shkresën e Gjykatës Kushtetuese për lëndën KO 63/12,
- c. Njoftim i grupit punues lidhur me punën në shqyrtimin e Kodit të Procedurës Penale.

Albulena Haxhiu propozoi që të hiqet nga rendi ditës pika e katërt, pasi nuk e kemi pas materialin me kohë.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.06.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 18.06 dhe 02.07.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë juridike falas;

Komisioni i shqyrtoi propozimet nga radhët e kandidatëve të propozuar nga institucionet e parapara me ligj dhe në bazë të dokumentacionit të ofruar nga propozuesit për kandidatët e lartpërmendur për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas, Komisioni, në vështrim të nenit 11 të Ligjit për ndihmë juridike falas Nr. 04/L-17, vlerësoi se nuk ka pengesa ligjore që të emërohen anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas kandidatët e propozuar, prandaj i rekomandoi Kuvendit që t'i emërojë anëtarë të këtij Këshilli.

Lidhur me këtë Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas, këta kandidatë:

1. Emrush Kastrati – Ministria e Drejtësisë,
2. Fadil Rracaj- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
3. Nenad Stojçetoviç – Ministria për Komunitete dhe Kthim,

4. Bahrije Berisha – Ministria e Financave,
5. Armend Krasniqi – Oda e Avokatëve të Kosovës,
6. Afrim Shala – Gjykata Supreme, dhe
7. Shukrije Gashi – OJQ “ Partners Kosova”.

4. Shqyrtimi i projektligjit për shfuqizimin e neneve 37,38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës;

Komisioni vendosi që për shqyrtimin e projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës të formohet një grup punues në këtë përbërje: Armend Zemaj, kryesues Behar Selimi, Albulena Haxhiu dhe Jasmina Zivkoviq, anëtarë.

5. Shqyrtimi i kërkesës së pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës;

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Bashkimit të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës, lidhur me zbatimin e Ligjit për buxhetin për vitin 2012. Komisioni konstatoi se çështja për rritje të pensioneve prej 26%, duke filluar prej 1 janarit 2012, nuk është në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion. Andaj, kërkesa si e tillë të procedohet në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtim të mëtejshëm.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-124 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-203 për Metrologji;

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-124 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-203 për Metrologji dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-124 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-203 për Metrologji, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
7. **Njoftimi i Komisionit me formularët e deklaramit të pasurisë për zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit.**

Komisioni ka pranuar formularët e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe lidhur me këtë deputeti Ardian Gjini tha se mbikëqyrja e çështjeve të tilla do ishte gabim për faktin se Komisioni nuk ka përgjegjësi të tilla. Komisioni vetëm duhet të njoftohet me formularët e deklaramit të pasurisë për zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Ishte konstatim i përgjithshëm se zyrtarët e agjencisë në pajtim me ligjin i kanë dorëzuar formularët e deklaramit të pasurisë.

8 Të ndryshme

a). Reagimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Institutit Gjyqësor lidhur me projektligjin për pagat e funksionarëve publikë

Kryetari e njoftoi komisionit se Këshilli Gjyqësor dhe Instituti Gjyqësor ka paraqitur reagim lidhur me projektligjin për pagat e funksionarëve publikë. Ai tha se për këtë projektligj nuk jemi Komision Funksional dhe kur të marrim raportin nga komisionet e tjera, në cilësi të komisionit kryesor, japim opinionin tonë.

b). Njoftim me shkresën e Gjykatës Kushtetuese për lëndën KO 63/12,

Kryetari i njoftoi me shkresën e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal ai tha se kjo kërkesë ka ardhur gjatë kohës kur Komisioni ka qenë në pushim dhe nuk i kemi kthyer përgjigje edhe pse përgjigja e Komisionit nuk e ndal gjykatën ta japë opinionin e tij. Kjo sepse edhe në shkresë të gjykatës thuhet jepni komentet “nëse keni”.

c). Njoftim i grupit punues lidhur me punën në shqyrtimin e Kodit të Procedurës Penale

Behar Selimi, në cilësi të kryesuesit të grupit punues e njoftoi Komisionin se deri me tani nuk ka mbajtur asnjë takim për shkak të pushimeve. Ai e njoftoi Komisioni se takimi i radhës do të mbahet më 28.08.2012, ku do të ftohen edhe ekspertet dhe do të vazhdojmë amendamentimin e këtij projekt-kodi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi Mbështetës i Komisionit

